

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 5.4.2007**

**TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE DANA 5.04.2007.GODINE**

PRILL - APRIL 2007

KRYETARI – Të nderuar të pranishëm. E hapi mbledhjen plenare të Kuvendit të Kosovës për të cilën propozoj këtë

R e n d d i t e

1. Fjala e hapjes e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha,
2. Fjala e presidentit Fatmir Sejdiu dhe e anëtarëve të tjerë të Grupit të Unitetit.
3. Miratimi i Deklaratës së Kuvendit.

Në sallë aktualisht janë 101 deputetë.

Fjalën e kërkon Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ – Prema predloženom dnevnom redu, prva tačka je uvodna reč. Druga tačka je rječ predsjednika Kosova i drugih članova grupe Jedinstva, odnosno kako bih ja nazvao takozvane grupe Jedinstva.

S obzirom da će se danas razmatrati jedna vrlo važna tema, hoću da govorim u ime zajednice, u ime dve zajednice najmanje, a takođe i u ime većinske zajednice koje sam godinama predstavljao, i hoću da znam i hocu da govorim o drugoj tački dnevnog reda. To je ono što sam hteo da kažem.

KRYETARI – Ju faleminderit.

I nderuari president i Kosovës dhe njihërit kryetar i Ekipit të Unitetit z. Sejdiu.

Të nderuar anëtarë të tjerë të Ekipit të Unitetit, kryeministër Çeku, z. Thaçi dhe z. Surroi, të nderuar ministra dhe zëvendësministra. Të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Zonja dhe zotërinj.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka nisur procesin e diskutimit për statusin e Kosovës. I Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara z. Ahtisari më 3 prill paraqiti dhe argumentoi raportin e tij për Kosovën. Ky është një moment i rëndësishëm dhe historik për Kosovën. Pardje, për herë të parë, në organin më të lartë të Kombeve të Bashkuara, në formë zyrtare u dëgjua fjala e presidentit të Kosovës z. Fatmir Sejdiu.

Me përkrahjen që iu dha pakos nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Bashkimi Evropian, nga pjesë të tjera të botës dhe nga vetë Sekretari i Përgjithshëm z. Ban Ki Mun, jo vetëm që i jepet fund një procesi mjaft të rëndë dhe të mundimshëm të bisedimeve mbi 14 muajshe për statusin e Kosovës dhe këputen shpresat e atyre që ende ëndërrojnë në mundësitë e riciklimit të atyre bisedimeve, por edhe u shënua fillimi i fundit të njërës ndër epokat më të errëta në historinë e Kosovës dhe të popullit të saj. Kjo nënkupton fundin e robërisë dhe fillimin e realizimit të sigurt dhe shumë të shpejtë të aspiratave krejtësisht ligjore të këtij populli për të jetuar i lirë dhe sovran në trojet e veta. Secili prej nesh, tashmë jemi prononcuar për rëndësinë e këtij momenti, pra për fillimin e bisedimeve në Këshillin e Sigurimit lidhur me statusin e Kosovës.

Sot jemi mbledhur të deklarohe mi dhe si Kuvend lidhur me këtë fazë të procesit, siç kemi qenë vazhdimisht bashkë me Grupin e Unitetit gjatë këtyre muajve të bisedimeve e jemi